EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8437
E shtunë, 21 nëntor 2026
Çmimi 0. 50 €

Kuvendi miraton në parim buxhetin 4.27 miliardë euro për vitin 2027

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

NISMA E RE E KOSOVËS PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR SPECIALEN SHIHET JOSERIOZE

FAQE 4-5



Pas dështimit të ndryshimeve në Ligjin për Gjykatën Speciale, Kosova po përgatit një nismë të re. Por ekspertët vlerësojnë se kjo përpjekje dështmon mungesë serioziteti dhe vullneti politik si dhe kalkulime politike

OVLUÇK-JA KËRKON MIRATIM TË SHPEJTË TË NDRYSHIMEVE NË LIGJIN PËR SPECIALEN, NË TË KUNDËRTËN PARALAJMËRON PROTESTA

F. 3



MUSMURATI U DREJTOHET DEPUTETËVE, KËRKON LLOGARIDHËNIE PËR BLLOKIMIN E BLERJES SË 100 KAMIONËVE PËR PASTRIMIN E PRISHTINËS

F. 6



OPINION

SI U FORMUA UÇK-ja NË JUNIK

F. 8-9

Shkruan: Hajdin ABAZI



AKTUALE



KATËR PËRFUNDIMET NGA TAKIMI HISTORIK MES TRUMPIT, XI-së DHE PUTINIT

F. 2

RASTI I ARLINDA ZEKAJT, DREJTORESHA E MIRËQENIES SOCIALE NË PEJË: NUK KISHA PËRGJEGJËSI TË DREJTPËRDREJTË PËR RASTET E DHUNËS

F. 7

EKONOMI



AKB: MBI 7 MILIARDË EURO REMITANCA NGA DIASPORA, VETËM 2 PËR QIND ORIENTOHEN NË BIZNES DHE PRODHIM

F. 7

KOMUNAT SHKËMBEJNË PËRVOJA DHE AVANCOJNË PRAKTIKAT PËR FINANCIM PUBLIK MË TRANSPARENT DHE LLOGARIDHËNËS TË OSHC-ve

F. 8

SPORT

HIDHET SHORTI PËR "PLAY-OFF" DHE ÇEREKFINALET E LIGËS SË KOMBEVE

F. 11

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

KATËR PËRFUNDIMET NGA TAKIMI HISTORIK MES TRUMPIT, XI-së DHE PUTINIT

SHENZHEN, 20 NËNTOR - Presidenti amerikan Donald Trump, lideri kinez Xi Jinping, dhe presidenti rus Vladimir Putin, e zhvilluan një takim historik në margjinat e samitit të Bashkëpunimit Ekonomik Azi-Paqësor (APEC), në Shenzhen. Takimi u solli përfitime të kufizuara të tre liderëve, por nuk prodhoi marrëveshje që do ta ndryshonin rrjedhën e ngjarjeve.

Samiti i 19 nëntorit, i cili kishte rëndësi të veçantë politike, ishte i pari ku liderët e tanishëm të tri fuqive më të mëdha bërthamore në botë u takuan së bashku, pa praninë e liderëve të tjerë. Megjithatë, Putini dhe Xi-ja janë takuar rreth 50 herë më parë.

Ndonëse samiti u karakterizua më shumë nga simbolika sesa nga përmbajtja konkrete, ai ka rëndësi për politikat e jashtme të Shteteve të Bashkuara, Kinës dhe Rusisë. Takimi vuri në pah ndikimin e këtyre vendeve në skenën ndërkombëtare, por edhe kufijtë e fuqisë së tyre.

Më poshtë mund t'i lexoni katër përfundimet e nxjerra nga samiti, bazuar në intervistat që Radio Evropa e Lirë zhvilloi me akademikë dhe analistë.

Putini përfitoi më së shumti


I izoluar kryesisht në arenën ndërkombëtare qëkurse Moska e nisi pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës, në shkurt të vitit 2022, Putini mbërriti në samitin e APEC-ut me pritshmëritë më të ulëta për sukses krahasuar me dy liderët e tjerë. Vetëm duke marrë pjesë në këtë ngjarje, për herë të parë që nga viti 2017, dhe duke biseduar drejtpërdrejt me Trumpin dhe Xinë për sigurinë globale, Putini doli nga izolimi diplomatik.

"Putini përfitoi shumë nga ky takim. Ai ishte fituesi më i madh i tij", tha për Radion Evropa e Lirë, Elizabeth Wishnick, eksperte për marrëdhëniet mes Kinës dhe Rusisë në Korporatën CNA, një institut amerikan për hulumtime në fushën e mbrojtjes, me seli në Virxhinia.

Izolimi i liderit rus "u zvogëlua jashtëzakonisht shumë në aspektin e imazhit, ndoshta edhe në realitet, për shkak të 'deklaratës së përbashkët të paqes' pas takimit", tha Sari Arho Havren, bashkëpunëtore në Institutin Mbretëror për Shërbime të Bashkuara (RUSI), organizatë britanike për hulumtime në fushën e sigurisë.

Deklarata e përbashkët bëri thirrje për zvogëlimin e rreziqeve bërthamore dhe forcimin e stabilitetit ndërkombëtar, por nuk përmbante shumë zotime konkrete.

Havren theksoi se të tri vendet vunë në pikëpyetje legjitimitetin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare (GJPN), e cila në



mars të vitit 2023 lëshoi fletarrestim për Putinin nën dyshimin për krime lufte në Ukrainë.

Në deklaratë të tre liderët theksuan se "vendimet e institucioneve ndërkombëtare duhet ta respektojnë pëlqimin e shteteve dhe imunitetin e zyrtarëve të tyre". Ata, po ashtu, "u pajtuan se Gjykata Penale Ndërkombëtare dhe institucionet e ngjashme nuk duhet të tejkalojnë apo keqpërdorin kompetencat e tyre".

Gjatë pjesës publike të takimit, Trumpi e quajti GjPN-në "organizatë të pakontrolluar globaliste".

Deklarata, po ashtu, bëri me dije se ShBA-ja, Kina dhe Rusia synojnë "ta rrisin prodhimin dhe furnizimin me produkte të rafinuara të naftës, në dobi të të gjitha vendeve", duke mbështetur kështu në mënyrë efektive sektorin e naftës të Rusisë, i cili po përballet me vështirësi.

Samiti i "mirorkestruar" i Xi-së i sjell përfitime Kinës

Krahasuar me Putinin, Xi Jinping kishte më pak për të përfituar nga samiti trepalësh. Kina nuk përballet me vështirësi të ngjashme diplomatike apo ekonomike. Megjithëse ka tensione në marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara, Xi-ja ka arritur ta përcaktojë drejtimin e marrëdhënieve mes dy vendeve përmes kornizës së tij për "stabilitet strategjik konstruktiv".

Megjithatë, Xi duhej të dëshmonte se Kina ishte në gjendje të organizonte një takim të nivelit të lartë në margjinat e samitit më të rëndësishëm ekonomik të Azisë, pa e lënë në hije ngjarjen kryesore.

Samiti ishte "i nivelit të lartë dhe i mirorkestruar. Mund ta quani sukses" për Kinën, tha për Radion Evropa e Lirë Yun Sun, drejtoreshë e Programit për Kinën në Qendrën Stimson, me seli në Uashington.

Ajo nënvizoi se "nuk është e lehtë të negociohet një deklaratë e përbashkët trepalëshe, me të cilën pajtohen të gjitha palët. Por, kompromisi është se rezultatet nuk përfshijnë shumë hollësi për çështjet e diskutuara".

"Mendoj se Xi Jinping mori pikërisht atë që dëshironte, duke dëshmuar se është ai që e drejton agjendën e çështjeve globale", tha Havren.

Sipas agjencisë shtetërore kineze të lajmeve Xinhua, lideri kinez e cilësoi takimin si "pozitiv, konstruktiv dhe frytdhënës".

Veçanërisht, Xi iu përshtat interesimit të Trumpit për të diskutuar çarmatimin bërthamor, pa marrë përsipër ndonjë veprim konkret. Me një arsenal prej rreth 620 kokash bërthamore krahasuar me më shumë se 5 000 që kanë ShBA-ja dhe Rusia veç e veç, Pekini vlerëson se pjesëmarrja e tij në bisedimet për çarmatimin bërthamor do të ishte e parakohshme dhe potencialisht e dëmshme për sigurinë kombëtare.

Në deklaratën e përbashkët, Xi, Trump dhe Putini "ritheksuan se lufta bërthamore nuk mund të fitohet dhe nuk duhet të ndodhë kurrë".

Kjo është një formulë standarde që lideri kinez e ka përdorur prej vitesh.

Ndërkaq, zotimi i tyre për të "zhvilluar dialog për zvogëlimin e rreziqeve bërthamore dhe parandalimin e përhapjes së armëve bërthamore" mbetet i paqartë dhe i mungojnë angazhimet konkrete.

Trumpi i përmbushi pritshmëritë e veta

Presidenti amerikan kishte vendosur pritshmëri modeste para samitit dhe arriti t'i përmbushte ato, vlerësojnë analistët. "Presidenti Trump dëshironte që të dëshmonte publikisht, në një kohë kur vëmendja e botës është përqendruar mbi të, se po përpiqet të arrijë marrëveshje për kontrollin e armëve bërthamore me dy fuqitë e tjera të mëdha bërthamore. Dhe ai e arriti këtë", tha për Radion Evropa e Lirë Ross Darrell Feingold, avokat dhe analist i rrezikut politik, me seli në Taipei.

Sa i përket luftës me Iranin, Trump kishte thënë para samitit se dëshironte që kjo çështje të diskutohej, por konflikti nuk u përmend në deklaratën e përbashkët të tre liderëve. As Putini dhe as Xi nuk folën publikisht për luftën me Iranin gjatë samitit të APEC-ut. "Kina dhe Rusia nuk mund dhe nuk do t'i ofrojnë asnjë ndihmë Trumpit për t'i dhënë fund konfliktit me Iranin. Po ashtu, ato nuk do ta nxisin Iranin që të luftojë kundër SHBA-së", tha Feingold. "Qasja më e sigurt për Kinën dhe Rusinë, të cilën ato po e ndjekin vazhdimisht, është të bëjnë thirrje për paqe".

Pavarësisht mungesës së rezultateve konkrete diplomatike, Trumpi mund ta paraqesë samitin si sukses, tha për Radion Evropa e Lirë një ish-zyrtar i lartë i Departamentit amerikan të Tregtisë, i cili kishte punuar për çështjet që lidhen me Kinën.

Duke kërkuar të mbetet anonim për të folur haptazi, ai tha se "Xi Jinping ka arritur ta magjepsë plotësisht presidentin Trump. Madje, e priti Trumpin në aeroport me një përqafim. Këto janë gjëra që Trumpi i vlerëson shumë".

Trumpi e përshkroi përqafimin e Xi-së si "fitore të madhe për ne" dhe si shenjë të "respektit të madh".

Marrëdhëniet miqësore me Trumpin përbëjnë një ndryshim të mirëpritur për Xi-në, pas tensioneve që karakterizuan raportet ShBA - Kinë gjatë presidencës së Joe Bidenit dhe mandatit të parë të Trumpit. Trysnia më e vogël nga Uashingtoni i ka dhënë Pekinit më shumë hapësirë për t'i përmbushur synimet e veta strategjike në politikën e jashtme.

"Xi duhet të jetë mjaft i kënaqur me rezultatet, edhe pse e di se kjo situatë nuk mund të zgjasë përgjithmonë", tha zyrtari.

Diplomacia e fuqive të mëdha ka kufijtë e saj

Në fund, sipas analistëve, samiti trepalësh mund të mbahet mend jo vetëm për pamjet e veçanta, por edhe për mungesën e rezultateve konkrete.

Kur Putini e hodhi për herë të parë idenë e këtij samiti muajin e kaluar, Ukraina dhe vendet evropiane shprehën shqetësimin se lideri rus mund të përpiqej të negocionte një marrëveshje paqeje pa pjesëmarrjen e tyre.

Megjithatë, një rezultat i tillë nuk ishte kurrë i mundur, duke pasur parasysh se Pekini nuk dëshiron t'i dëmtojë marrëdhëniet me Evropën. "Kina ende ka nevojë për Evropën në aspektin ekonomik dhe është përpjekur ta paraqesë veten si fuqi neutrale", tha Havren. Ajo shtoi se vendimi i Pekinit për të mos e përfshirë Ukrainën në agjendë ishte "një zgjedhje strategjike".

Nuk ishte rastësi që Ukraina ndërmori sulme me dronë dhe raketa ndaj urës së Krimesë, duke shembur një pjesë të segmentit rrugor të saj, pak para samitit të APEC-ut, tha Wishnick. "Kjo dërgon mesazhin se liderët botërorë nuk mund t'i japin fund këtij konflikti pa përfshirjen e Ukrainës dhe liderëve evropianë", shtoi ajo.

Ndërkohë, më 18 nëntor, Irani ndërmori sulme ndaj vendeve të Gjirit. Sulmet me dronë dhe raketa ndaj Bahrejnit dhe Kuvajtit ishin të parat pas rreth dy muajsh. Edhe lideri i Koresë së Veriut, Kim Jong Un, i cili i ka ofruar Rusisë armë dhe trupa për luftën në Ukrainë, u largua nga samiti i APEC-ut pa u takuar me Trumpin. Presidenti amerikan kishte thënë më herët se mund të takoheshin.

"Fuqitë e mëdha kanë shumë ndikim, por nuk mund t'i kontrollojnë ngjarjet në terren", tha Wishnick. "Ka përfunduar koha kur liderët uleshin rreth një tavoline dhe vendosnin për fatin e botës. Për zgjidhjen e problemeve, ata do të duhet të angazhohen më gjerësisht edhe me shtetet e tjera".

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

KUVENDI MIRATON NË PARIM BUXHETIN 4.27 MILIARDË EURO PËR VITIN 2027

Pas një debati disaorësh në mes të pozitës dhe opozitës, Kuvendi i Kosovës me 61 vota për, 8 kundër dhe asnjë abstenim, miratoi në parim Projektligjin për ndarjet buxhetore të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2027, i cili arrin vlerën prej 4 miliardë e 270 milionë eurosh

EPOKA E RE Faton DËRMAKU



PRISHTINË, 20 NËNTOR - Kuvendi i Kosovës ka mbajtur seancë plenare, të drejtuar nga kryetarja Albulena Haxhiu dhe, pjesërisht, nga nënkryetari Ardian Gola. Fillimisht deputetët miratuan plotësimin e rendit të ditës me disa pika, që përfshinin shqyrtimin e projektligjeve për ratifikimin e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare, si dhe çështje që lidhen me sektorin e energjisë. Ndërkaq, nuk kaluan dy mocionet për heqjen e pikave të caktuara nga rendi i ditës.

Seanca vazhdoi me deklarimet jashtë rendit të ditës dhe pyetjet parlamentare, në të cilat kryeministri Albin Kurti dhe anëtarë të kabinetit qeveritar iu përgjigjën deputetëve.

Pas miratimit të mocionit për shmangien nga afati procedural i paraparë me Rregulloren e Kuvendit, deputetët miratuan Projektligjin nr. 11/L-30 për Ratifikimin e Konventës për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Huaja në Çështje Civile apo Tregtare; Projektligjin nr. 11/L-31 për Ratifikimin e Protokollit për ndryshimin e Marrëveshjes mbi Statusin dhe Funksionet e Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur dhe Projektligjin nr. 11/L-35 për Ratifikimin e Konventës për Marrëveshjet për Zgjedhjen e Gjykatës.

Kryeministri i Qeverisë së Kosovës, Albin Kurti, gjatë prezantimit dhe arsyetimit të Projektligjit nr. 11/L-028 për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2027, theksoi se projektbuxheti i vitit të ardhshëm është hartuar mbi bazën e qëndrueshmërisë ekonomike dhe fiskale.

Ai bëri me dije se buxheti i planifikuar për vitin 2027 arrin vlerën prej 4 miliardë e 270 milionë eurosh, që paraqet një rritje prej rreth 200 milionë eurosh krahasuar me buxhetin e rishikuar të vitit 2026, përkatësisht 300 milionë euro më shumë në raport me buxhetin fillestar të po këtij viti. "Nga ky buxhet, 908 milionë euro do të transferohen drejtpërdrejt për financimin e komunave. Kjo përbën nivelin më të lartë të financimit komunal deri më sot dhe pasqyron rritjen e vazhdueshme të granteve qeveritare, si dhe mbështetjen për ofrimin e shërbimeve publike sa më afër qytetarëve", tha kryeministri Kurti.

Në këtë buxhet, shtoi ai, është paraparë edhe rritja e mbështetjes financiare për ekipet mbrojtëse të katër ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në përputhje me kërkesat e paraqitura nga vetë ekipet mbrojtëse.

Kryeministri Kurti më pas foli për pesë kapitujt kryesorë, të cilat përbëjnë shtyllat kryesore të planifikimit buxhetor për vitin e ardhshëm.

Në kapitullin e parë ai u ndal te pagat dhe mirëqenia e punonjësve publikë, duke theksuar se është planifikuar pagesa e pagës së 13. Krahas kësaj, kryeministri Kurti bëri me dije se nga 1 korriku i vitit 2027 koeficienti i pagave do të rritet në 120 euro.

Sa i përket kapitullit të dytë, kryeministri Kurti përmendi mbështetjen më të madhe për familjet dhe fëmijët, duke e veçuar këtë fushë si një ndër prioritetet e buxhetit për vitin e ardhshëm.

Në kapitullin e tretë kryeministri Kurti foli për shërbimet publike dhe shëndetësinë, ndërsa në kapitullin e katërt u ndal tek investimet kapitale dhe transformimi i infrastrukturës. Ndërkaq, në kapitullin e pestë, kryeministri Kurti përmendi aviacionin, turizmin dhe zhvillimin ekonomik.

Në këtë kuadër ai veçoi si një ndër nismat e reja të projektbuxhetit edhe themelimin e një kompanie kombëtare ajrore.

Deputeti Enver Haliti, në emër të grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, shprehu përkrahjen për Projektbuxhetin e vitit 2027, duke e cilësuar atë si një dokument që ndërthur zhvillimin ekonomik me mirëqenien sociale, investimet publike me forcimin e shërbimeve, si dhe përgjegjësinë fiskale me nevojat konkrete të qytetarëve.

Gjatë fjalës së tij Haliti theksoi se ky projektbuxhet reflekton programin qeverisës dhe prioritetet e tij përmes vendimeve konkrete. Ai vlerësoi se mbështetja për këtë projektbuxhet bazohet në synimin për të siguruar zhvillim ekonomik, mirëqenie sociale dhe shërbime më të fuqishme publike, duke ruajtur njëkohësisht përgjegjësinë fiskale me nevojat konkrete të qytetarëve.

Deputeti Mërgim Lushtaku, në emër të grupit parlamentar të PDK-së, ngriti pikëpyetje lidhur me realizimin e investimeve kapitale, përmbushjen e zotimeve të qeverisë dhe ndikimin që rritja e buxhetit do të ketë në mirëqenien e qytetarëve. Ai theksoi se buxheti, i cili kap vlerën prej rreth 4 miliardë e 270 milionë eurosh, nuk duhet të vlerësohet vetëm në bazë të shumës së përgjithshme, por nga rezultatet konkrete që sjell për qytetarët.

Ndër të tjera, deputeti Lushtaku vuri në pikëpyetje nëse rritja e buxhetit po reflektohet edhe në përmirësimin e kushteve të jetesës, duke përmendur pagat, pensionet, çmimet e produkteve ushqimore dhe faturat e larta të energjisë elektrike.

Deputeti Lumir Abdixhiku, në emër të grupit parlamentar të LDK-së, kritikoi qasjen buxhetore të qeverisë, duke paralajmëruar se rritja e vazhdueshme e çmimeve dhe shtimi i nevojës për ndihma financiare mund të krijojnë një cikël të pafavorshëm ekonomik.

Ai tha se do të mbesim pa investime për të cilat ka shumë nevojë Kosova. "Dhe mos më keqkuptoni. Kjo kritikë vjen nga unë dhe nga Lidhja Demokratike e Kosovës, që për synim programor kishim dhe kemi koeficientin 150. Pra, ambicia jonë për pagat është edhe më e lartë, por ambicia për investime është shumëfish më e lartë. Dhe po, mund të bëhen të dyja. Edhe ndihma, edhe investime. Por fillimisht shumë më shumë investime sesa ndihma", tha Abdixhiku, duke shtuar se nuk ka sektor, nuk ka fushë, nuk ka drejtim që nuk ka nevojë për investime sot në Kosovë.

Deputetja Teuta Haxhiu, duke folur në emër të grupit parlamentar të Aleancës, theksoi se Projektbuxheti për vitin 2027 është konsumues dhe jo mjaftueshëm zhvillimor. Ajo përmendi se qytetarët e vendit po përballen me rritje të çmimeve dhe inflacion, ndërsa pjesa më e madhe e të hyrave buxhetore sigurohet nga tatimet.

Haxhiu kritikoi edhe mënyrën se si është planifikuar rritja e koeficientit të pagave për punëtorët në sektorin publik, e cila pritet të hyjë në fuqi nga korriku i vitit 2027, duke shtuar se rritja do të duhej të zbatohej nga 1 janari, në mënyrë që punonjësit të përfitojnë gjatë gjithë vitit. Duke folur për shpërndarjen e mjeteve për komunat, ajo tha se ndarjet nuk janë të barabarta dhe nuk marrin parasysh nevojat e qytetarëve.


Kryetari i grupit parlamentar i Listës Serbe, Igor Simiq, theksoi se ky projektbuxhet nuk parasheh asnjë projekt kapital për komunitetin serb. Ndërkaq, deputetja e grupit parlamentar Multietnik, Emilia Rexhepi, kërkoi që në projektbuxhet të përfshihen zona të reja ekonomike, si dhe investime konkrete që do të ndikonin në zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Gjatë shqyrtimit të Projektligjit për ndarjet buxhetore u zhvillua debat parlamentar, në të cilin morën pjesë deputetë nga grupe të ndryshme parlamentare dhe anëtarë të kabinetit qeveritar.

Pas përfundimit të debatit, Kuvendi i Republikës së Kosovës me 61 vota për, 8 kundër dhe asnjë abstenim miratoi në parim Projektligjin për ndarjet buxhetore të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2027.

Në vazhdim të seancës, pas kalimit të mocionit për shmangien nga afati procedural i paraparë me Rregulloren e Kuvendit, propozuar nga kryetarja e grupit parlamentar e LV-së, Arbërie Nagavci, deputetët miratuan vendimin e Qeverisë së Kosovës për masat emergjente për furnizimin me energji elektrike si dhe Projektligjin për Rregullatorin e Energjisë.

Kuvendi, po ashtu, miratoi në parim Projektligjin për Efiçiencë të Energjisë dhe Projektligjin për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore, kurse pikat e tjera të mbetura të kësaj seance, kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, tha se do të shqyrtohen të enjten.



NISMA E RE E KOSOVËS PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR SPECIALEN SHIHET JOSERIOZE

Pas dështimit të ndryshimeve në Ligjin për Gjykatën Speciale, Kosova po përgatit një nismë të re. Por ekspertët vlerësojnë se kjo përpjekje dështmon mungesë serioziteti dhe vullneti politik si dhe kalkulime politike

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Kosova do të ndërmarrë një nismë të re për ta ndryshuar Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, pasi ndryshimet e propozuara më herët në këtë ligj të vitit 2015 nuk u miratuan, mes kundërshtimeve të ashpra nga ndërkombëtarët.

Megjithatë, ekspertët e kanë vënë në pikëpyetje seriozitetin e përpjekjes së re të kryeministrit Albin Kurti dhe Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në opozitë.

Kurti dhe PDK-ja u pajtuan për një nismë të re të enjten, në ditën kur votimi për ndryshimet e propozuara në këtë ligj, të cilat do t'ia kufizonin kompetencat kësaj gjykate, u shty për herë të dytë brenda pak ditësh.

Ndryshimet e miratuara në tetor u kthyen në Kuvend për rishqyrtim nga presidentja e vendit, Justina Shiroka Pula, me kërkesën e iniciueses, PDK-së. Ato ishin miratuar pak javë pasi Gjykata Speciale i dënoi në shkallë të parë katër ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kurti u takua të enjten me ushtruesen e detyrës së kryetares së PDK-së, Vlora Çitaku, për të diskutuar për ndryshimet në Ligjin për Gjykatën Speciale. Ai kishte shprehur rezerva ndaj hyrjes në fuqi të ndryshimeve, të cilat kishin nxitur kundërshtime ndërkombëtare.

PDK-ja kishte kërkuar që ndryshimet të miratoheshin fillimisht dhe më pas, brenda dy javësh nga hyrja në fuqi e ligjit, të bëheshin ndryshime të tjera për të adresuar shqetësimet ndërkombëtare. Por, në fund, partia hoqi dorë nga kjo kërkesë.

Duke folur në një seancë të Kuvendit, Kurti tha se nuk dyshon "në qëllimin e mirë" të PDK-së për ta ndryshuar ligjin, por shtoi se "nuk mjafton vetëm kjo - duhet të kemi sukses, duhet të dalim fitimtarë". "Për këtë na duhet një ligj, i cili nuk kthehet mbrapsht, nuk anulohet, por një ligj që ka efekt në realitet, në praktikë", tha Kurti.

Çitaku, duke folur më vonë në një konferencë për media, tha se me kryeministrin janë pajtuar për përmbajtjen e ligjit dhe për ndryshimet që duhen bërë në të. "Dallimet kanë qenë tek procedura parlamentare. Sot u pajtuam edhe për rrugën që do ta ndjekim. Nismën e re ligjore e sjellim menjëherë javën tjetër, me propozime tona konkrete dhe me propozimet e ekspertëve", ka thënë Çitaku.

"Mungesë serioziteti, kalkulime politike"

Politologu Dritëro Arifi dhe njohësi i çështjeve të drejtësisë, Ehat Miftaraj, vlerësojnë se kjo përpjekje e re për ndryshimin e ligjit, mbi bazën e të cilit Kuvendi i Kosovës e themeloi para një dekade gjykatën në Hagë, dëshmon mungesë të vullnetit dhe seriozitetit politik, si dhe kalkulime të LVV-së dhe PDK-së.

Arifi thotë për Radion Evropa e Lirë (REL) se kjo nismë është "një kamuflim i dështimit, papërgjegjësisë dhe joseriozitetit" për ta ndryshuar dhe plotësuar këtë ligj me kohë.

Ndërkaq, Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) thotë për REL-in se "fatkeqësisht, si LVV-ja, ashtu edhe lidershipi i PDK-së, kanë vendosur që me një temë kaq të ndjeshme, të luajnë lojëra politike".

Arifi thekson se pushteti dhe opozita kanë treguar "mungesë serioziteti" për ta trajtuar mirëfilltë këtë çështje qëkurse u paraqitën ndryshimet ligjore pas vendimit dënues të 16 shtatorit ndaj ish-krerëve të UÇK-së.

Dënimi i Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit - të cilët udhëhoqën UÇK-në gjatë luftës së saj kundër forcave serbe më 1998-'99 - me gjithsej 81 vjet burgim për krime lufte nxiti protesta të shumta në vend.

Protestat ishin të përnatshme dhe përfunduan në natën kur Kuvendi i miratoi ndryshimet që synonin t'ia kufizonin dukshëm kompetencat Gjykatës Speciale.

Arifi beson se ndryshimet u sollën "vetëm si njëfarë lloj arsyetimi që protestat të mos përshkallëzoheshin". "Nuk kishte seriozitet për të bërë diçka më konkrete, pra për ta kufizuar, apo pse jo edhe për ta zhbërë gjykatën, sepse kjo gjykatë po vërehet që ka devijuar nga ajo për çka është themeluar", nënvizon Arifi.

Ndryshimet e reja

Çitaku tha se ndryshimet e reja do të bazohen në tekstin që Kuvendi e kishte miratuar në dy lexime në tetor, por nuk dha hollësi se çfarë do të përmbajnë ato.

"Mbi atë tekst do të bëjmë ndryshimet e nevojshme për ta bërë ligjin më të qëndrueshëm juridikisht dhe për t'u dhënë çlirimtarëve tanë mbështetje konkrete shtetërore", tha Çitaku.

Kurti, ndërkohë, nuk foli për përmbajtjen e ndryshimeve, por vetëm tha se ato duhet të jenë në përputhje me kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e Kosovës.

Politologu Arifi e quajti këtë "mungesë llogaridhënieje", duke theksuar se ata duhet të flasin publikisht se cilat pika duhet të preken dhe çfarë duhet të përmirësohet. "Çështja është se a do të ketë kuorum, sepse po vërehet që nuk ka një dakordim mbi këtë çështje. Më shumë është blerje e kohës dhe për të parë se kush si po reagon, sesa që ka seriozitet", nënvizon Arifi.

Miftaraj shton se partia në pushtet dhe PDK-ja ua kanë "borxh" qytetarëve dhe partive të tjera në Kuvend informimin për vendimin e sotëm, negociatat që kanë zhvilluar dhe hapat që do të ndërmarrin.

Çitaku tha se i pranon kritikat për mënyrën se si PDK-ja e kishte trajtuar këtë çështje nga dita e parë.

Ajo u zotua se këtë proces "do ta çojmë deri në fund", duke shtuar se "projektligjin do ta hartojmë dhe do ta sjellim në Kuvend për votim, më të plotë, më të qëndrueshëm juridikisht, më të zbatueshëm praktikisht".

Ndërkohë, Kurti tha se beson se "korrigjimi" i aktgjykimit dënues të 16 shtatorit duhet të ndodhë në shkallën e dytë, pra në Gjykatën e Apelit në Hagë.

Ai paralajmëroi se grupi punues

OVLUÇK-ja KËRKON MIRATIM TË SHPEJTË TË NDRYSHIMEVE NË LIGJIN PËR SPECIALEN, NË TË KUNDËRTËN PARALAJMËRON PROTESTA



PRISHTINË, 20 NËNTOR - Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL e UÇK-së) ka shprehur shqetësim për zhvillimet politike rreth plotësim-ndryshimeve të Ligjit për Dhomat e Specializuara, duke kërkuar që ky proces të përfundojë sa më parë.

Në një reagim publik, OVLUÇK-ja ka vlerësuar se është e papranueshme që një çështje kaq e rëndësishme të zvarritet për shkak të përplasjeve politike apo presionit të bashkësisë ndërkombëtare.

Organizata u ka bërë thirrje shumicës parlamentare dhe të gjitha subjekteve politike që t'i lënë anash dallimet partiake dhe ta përfundojnë këtë proces. "Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së po i përcjell me shqetësim zhvillimet politike rreth plotësim-ndryshimeve të Ligjit për Dhomat e Specializuara. Për ne, si veteranë të UÇK-së, është tërësisht e papranueshme që kjo çështje kaq e rëndësishme të zvarritet për shkak të përplasjeve politike apo presionit të bashkësisë ndërkombëtare. Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së u bën thirrje shumicës parlamentare dhe të gjitha subjekteve politike që t'i lënë anash dallimet partiake dhe ta përfundojnë sa më parë këtë proces", thuhet në reagimin për media.

Sipas OVLUÇK-së, qeveria dhe shumica parlamentare kanë përgjegjësi të veprojnë dhe të mos lejojnë që vonesat të pengojnë përfundimin e tij. Qeveria dhe shumica parlamentare duhet ta kenë të qartë se përgjegjësia e tyre është të veprojnë dhe të mos lejojnë që vonesat të bëhen pengesë për përfundimin e këtij procesi. Po ashtu, OVLÇK-ja rithekson se është e papranueshme dhe e pandershme që një çështje kaq e ndjeshme të shfrytëzohet për të krijuar ndasi politike apo për të thelluar përçarjet mes subjekteve politike", theksohet në reagimin e OVLUÇK-së.

Në reagim thuhet se, nëse procesi vazhdon të zvarritet dhe nuk përfundon së shpejti, OVLUÇK-ja do t'i kundërvihet kësaj qasjeje përmes organizimit të protestave gjithëpopullore. "Pavarësisht deklarimeve publike për vullnet politik, nëse ky proces vazhdon të zvarritet dhe nuk përfundon së shpejti, OVLUÇK-ja paralajmëron se do t'i kundërvihet kësaj qasjeje përmes organizimit të protestave gjithëpopullore. Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së kërkon që plotësim-ndryshimet e Ligjit për Dhomat e Specializuara të miratohen me procedurë të përshpejtuar, brenda afatit më të shkurtër që lejojnë procedurat parlamentare dhe institucionale", është thënë në reagimin e kësaj organizate.

FSK-ja FORCON LIDERSHIPIN DHE PROFESIONALIZMIN E TRUPËS SË NËNOFICERËVE



PRISHTINË, 20 NËNTOR - Në Qendrën e Përgatitjes Profesionale të Nënoficerëve në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë u mbajt ceremonia e përfundimit të Kursit të Kryekapterit, Kursit të Avancuar dhe Kursit Bazë të Nënoficerit, ku morën pjesë kursantë nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK).

Në mesin e të diplomuarve ishin edhe gjashtë nënoficerë të FSK-së, të cilët përfunduan me sukses trajnimet përkatëse, duke dëshmuar përkushtimin dhe angazhimin e vazhdueshëm të FSK-së në ngritjen profesionale, avancimin e lidershipit dhe zhvillimin e kapaciteteve të trupës së nënoficerëve.

Zhvillimi i një trupe nënoficerësh profesionistë, të përgatitur dhe të përkushtuar, të cilët udhëheqin me shembull, drejtojnë me profesionalizëm dhe kontribuojnë drejtpërdrejt në rritjen e gatishmërisë operacionale të njësive, mbetet një ndër prioritetet e FSK-së.

Investimi në zhvillimin profesional të nënoficerëve është investim në lidership, profesionalizëm dhe gatishmëri operacionale.

për Strategjinë Shtetërore për Apelin në Hagë, i themeluar nga qeveria në tetor dhe i udhëhequr nga zëvendëskryeministri i parë dhe ministri i Punëve të Jashtme, Glauk Konjufca, do ta sjellë javën e ardhshme draftin e parë të strategjisë shtetërore për ta ndihmuar ish-katërshen e UÇK-së në apelimin e dënimeve me burgim për krime lufte.

Megjithatë, mbetet e paqartë se çfarë do të përmbajë nisma e re ligjore dhe nëse Kurti e PDK-ja do të arrijnë të hartojnë një tekst që do të ketë mbështetjen e nevojshme politike dhe që do të jetë në përputhje me zotimet ndërkombëtare të Kosovës.

Ndryshimet që nuk kaluan

Ndryshimet kryesore që përfundimisht dështuan të kalonin synonin ngushtimin e juridiksionit të Gjykatës Speciale, duke e kufizuar atë kryesisht në pretendimet për trafikim organesh dhe në vrasje, torturë e trajtim mizor.

Ato parashihnin gjithashtu kufizimin e dënimit maksimal në 15 vjet burgim, si dhe mundësinë që të dënuarit t'i vuanin dënimet në Kosovë dhe të përfitonin nga falja presidenciale.

Rastet që do të mbeteshin jashtë juridiksionit të ri do të transferoheshin në sistemin e drejtësisë së Kosovës, bashkë me provat dhe dosjet përkatëse. Rastet në proces do të vazhdonin në apel në Hagë, ndërsa ndryshimet nuk nënkuptonin anulimin automatik të aktgjykimeve ekzistuese apo lirimin e të dënuarve.

Synimi për t'i miratuar këto ndryshime nxiti reagime nga ndërkombëtarët. Bashkimi Evropian paralajmëroi se ato binin ndesh me zotimet ndërkombëtare të Kosovës, të cilat lidhen me themelimin dhe funksionimin e Dhomave të Specializuara.

Këto zotime buronin nga shkëmbimi i letrave të prillit 2014 ndërmjet presidentes së atëhershme, Atifete Jahjaga, dhe shefes së BE-së, Catherine Ashton. Përmes këtij shkëmbimi, Kosova ishte zotuar që të konsultohej me Bashkimin Evropian për çdo ndryshim ligjor që prek mandatin ose procedurat e Dhomave të Specializuara.

Po ashtu, Kosova ishte zotuar të garantonte vazhdimin e punës së Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar deri në përfundimin e hetimeve dhe procedurave përkatëse.

Erërat e fuqishme shkaktuan dëme të shumta në Ferizaj

FERIZAJ, 20 NËNTOR - Erërat e fuqishme që përfshinë Ferizajn të enjten në mbrëmje kanë shkaktuar dëme në disa objekte shkollore e sportive, hapësira publike, biznese dhe ekonomi familjare.
Kryetari i komunës së Ferizajt, Agim Aliu, ka bërë me dije se ekipet emergjente janë në terren që nga mbrëmja e kaluar dhe orët e hershme të mëngjesit për t'i evidentuar dhe sanuar dëmet e shkaktuara nga moti i lig.
Aliu, së bashku me drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave dhe drejtorin e Arsimit, ka dalë sot në terren për t'i parë nga afër pasojat e erërave të fuqishme.
Ai ka bërë me dije se komuna do të përgatisë një raport të hollësishëm për dëmet e shkaktuara, ndërsa paralajmëroi se do ta kërkojë edhe mbështetjen e nivelit qeveritar për kompensimin e subjekteve të dëmtuara.



MUSMURATI U DREJTOHET DEPUTETËVE, KËRKON LLOGARIDHËNIE PËR BLLOKIMIN E BLERJES SË 100 KAMIONËVE PËR PASTRIMIN E PRISHTINËS

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Nënkryetarja e kryeqytetit, Besianë Musmurati, ka njoftuar të premten se komuna e Prishtinës u është drejtuar me letra zyrtare deputetëve të Kuvendit të Kosovës, duke kërkuar angazhimin e tyre institucional për zhbllokimin e projektit prej 74.1 milionë eurosh për modernizimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave në rajonin e Prishtinës.
Në një konferencë për medie, Musmurati theksoi se projekti, i përgatitur në bashkëpunim me bankën gjermane KfW, parasheh investime për blerjen e rreth 100 kamionëve të rinj, 10 mijë kontejnerëve, ndërtimin e qendrës për riciklimin dhe kompostimin e mbeturinave si dhe modernizimin e shërbimeve të pastrimit.
Ajo rikujtoi se për këtë projekt është punuar që nga viti 2023 në bashkëpunim ndërmjet komunës së Prishtinës, KRM "Pastrimi", Ministrisë së Financave dhe KfW-së, ndërsa Qeveria e Kosovës ka miratuar në parim nismën për marrëveshjen e kredisë më 18 dhjetor 2024. "Nuk po flasim për një ide që duhet të nisë nga zero. Po flasim për një projekt të përgatitur dhe të dakorduar mes palëve, i cili vazhdon të mbetet pa nënshkrimin e ministrit të Financave, Hekuran Murati", deklaroi Musmurati.
Nënkryetarja e cilësoi mosnënshkrimin e marrëveshjes si bllokadë të motivuar politikisht, duke



theksuar se pasojat po i bartin qytetarët e Prishtinës. "Prishtina nuk mund të vazhdojë ta paguajë çmimin e inateve partiake", u shpreh ajo.
Përmes letrave zyrtare, komuna e Prishtinës u kërkon deputetëve t'i përdorin mekanizmat parlamentarë për të kërkuar sqarime nga Ministria e Financave lidhur me arsyet e mosnënshkrimit të marrëveshjes dhe të angazhohen për tejkalimin e bllokadës.
Letrave u janë bashkëngjitur edhe tri dokumente zyrtare: 1. Dokumenti i KfW-së lidhur me projektin dhe financimin e tij. 2. Vendimi i Qeverisë së Kosovës i datës 18 dhjetor 2024, për miratimin në parim të nismës për marrëveshjen e kredisë. 3. Letra e përbashkët e Komunës së Prishtinës, KRM "Pastrimi" dhe KfW-së, drejtuar Ministrisë së Financave më 15 maj 2026. "Deputetëve nuk po u drejtohemi vetëm me një kërkesë. Po ua dorëzojmë edhe dokumentacionin që dëshmon se ky projekt është përgatitur dhe se institucionet janë njoftuar zyrtarisht për nevojën e finalizimit të tij. Presim që deputetët ta ushtrojnë përgjegjësinë e tyre institucionale dhe të kërkojnë llogaridhënie", theksoi Musmurati.
Në përfundim, nënkryetarja kërkoi përgjigje të qarta nga Ministria e Financave për arsyet e mosnënshkrimit të marrëveshjes dhe hapat konkretë që duhet të ndërmerren për realizimin e këtij investimi. "Sot po i dorëzojmë letrat. Tani presim përgjigje, përgjegjësi dhe veprime konkrete", përfundoi Musmurati.

KOMUNAT SHKËMBEJNË PËRVOJA DHE AVANCOJNË PRAKTIKAT PËR FINANCIM PUBLIK MË TRANSPARENT DHE LLOGARIDHËNËS TË OSHC-ve

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) organizoi punëtorinë ndërkomunale me temë "Shkëmbimi i përvojave dhe mësimi nga praktikat e komunave në financimin publik të organizatave të shoqërisë civile", duke bashkuar zyrtarë komunalë nga disa komuna.
Punëtoria krijoi një platformë për shkëmbimin e përvojave, diskutimin e praktikave të zbatuara në nivel lokal dhe identifikimin e mundësive për përmirësimin e proceseve të financimit publik të organizatave të shoqërisë civile në përputhje me Rregulloren MF-Nr. 04/2017 dhe Metodologjinë LOD.
Përmes diskutimeve tematike dhe punës praktike në grupe, pjesëmarrësit shqyrtuan përvojat konkrete të komunave, identifikuan sfidat në zbatimin e këtyre proceseve dhe hartuan rekomandime të përbashkëta për avancimin e transparencës, llogaridhënies dhe digjitalizimit.
Njëkohësisht u diskutuan nevojat për mbështetje të mëtejshme teknike dhe forcimin e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë.
Në përmbyllje të aktivitetit u bë edhe ndarja e certifikatave për zyrtarët komunalë që përfunduan me sukses ciklin katërmodular të trajnimeve të



AKK-së për Menaxhimin e Ciklit të Projekteve (MCP).
Fuqizimi i kapaciteteve institucionale dhe shkëmbimi i vazhdueshëm i përvojave ndërmjet komunave janë thelbësore për ndërtimin e praktikave më të qëndrueshme, transparente dhe gjithëpërfshirëse në financimin publik të organizatave të shoqërisë civile.
Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit "Fuqizimi i demokracisë pjesëmarrëse në komuna", të cilin e zbaton Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK), me mbështetjen e Programit Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor 3 (ReLOaD3), financuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatuar nga Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara (UNDP).

ZKA-ja auditon programet e mbështetjes për bujqësi dhe zhvillim rural

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), në kuadër të zbatimit të Planit Vjetor të Auditimit 2026/2027, ka filluar auditimin e performancës me temën "Efektiviteti i planifikimit dhe monitorimit të programeve të mbështetjes për bujqësi dhe zhvillim rural" për periudhën 2023-2026.
Auditimi do të vlerësojë nëse Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) siguron planifikim të bazuar në analiza dhe monitorim të programeve të orientuar drejt rezultateve.
Po ashtu, do të vlerësohet nëse Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB) i ka zbatuar në mënyrë efektive kontrollet për investimet e Programit të Zhvillimit Rural dhe kontrollet në terren të bazuara në rrezik për pagesat direkte.



RASTI I ARLINDA ZEKAJT, DREJTORESHA E MIRËQENIES SOCIALE NË PEJË: NUK KISHA PËRGJEGJËSI TË DREJTPËRDREJTË PËR RASTET E DHUNËS

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Komisioni Hetimor Parlamentar ka intervistuar të premten Albulena Mujaj-Bajraktaraj, drejtoreshë e Mirëqenies Sociale në komunën e Pejës, lidhur me rastin e vrasjes së Arlinda Zekajt në Vitomiricë të Pejës.

Gjatë raportimit para Komisionit, Mujaj-Bajraktaraj ka deklaruar se nuk ka pasur përgjegjësi të drejtpërdrejtë në trajtimin e rasteve të dhunës, përfshirë rastin e Zekajt, duke theksuar se detyra e saj lidhet me hartimin e politikave për zhvillimin e fushës sociale në nivel lokal.

Ajo ka folur për përgjegjësitë e saj institucionale, kapacitetet e Qendrës për Punë Sociale, si dhe takimin që kishte zhvilluar me të ndjerën pas paraqitjes së rastit në polici.

Në fillim të deklarimit, Mujaj-Bajraktaraj e ka cilësuar këtë si një nga përballjet më të vështira në jetën e saj, duke pretenduar se është gjykuar dhe linçuar padrejtësisht për përgjegjësi që, sipas saj, nuk i takojnë drejtpërdrejt, raporton "Ekonomia Online".

"Është një prej përballjeve më të vështira në jetën time, jo në aspektin e punës dhe përgjegjësisë institucionale që më takon, por në aspektin e përgjegjësive njerëzore, pasi atë e kam pasur bashkëvendase. Besoj se padrejtësisht jam gjykuar dhe linçuar me detyrime e përgjegjësi që drejtpërdrejt nuk më takojnë. Unë nuk trajtoj raste drejtpërdrejt, nuk jap mendime dhe nuk marr vendime në raport me fëmijët dhe rastet e dhunës. Jam drejtoreshë politike, në kuptimin që hartoj politika për zhvillimin e fushës sociale në nivel lokal. Kjo është përgjegjësia ime", ka deklaruar ajo.

E pyetur nga deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Adnan Rrustemi, nëse ishte takuar me Arlinda Zekajn, drejtoresha është përgjigjur pozitivisht, ndërsa ka mohuar pretendimet se e kishte detyruar të ndjerën ta tërhiqte ankesën. "Jo, nuk është e vërtetë", ka thënë ajo.

Duke folur për takimin, Mujaj-Bajraktaraj ka bërë me dije se ai ishte zhvilluar të hënën, më 13 korrik, pasi rasti ishte paraqitur në polici të premten, më 10 korrik, në orët e pasdites. "Takimi ynë ka ndodhur menjëherë pas paraqitjes së rastit në polici. Rasti është paraqitur më 10 korrik, ditën e premte, pasdite, sipas raportit të informacionit që kam. Edhe Arlinda ka ardhur menjëherë të hënën. Ka kërkuar takim me mua paradite, sapo kam filluar punën. Normalisht që e kam pritur. Secilin qytetar që kërkon takim me mua jam në dispozicion ta pres, ta udhëzoj dhe ta kryej funksionin për të cilin jam zgjedhur", është shprehur ajo.

Sipas saj, gjatë takimit Arlinda Zekaj kishte shprehur pakënaqësi lidhur me mënyrën e trajtimit të rastit në polici dhe vlerësimin profesional të bërë nga zyrtarët përkatës.

"Arlinda ka shprehur shqetësime për trajtimin e rastit në polici, ku kishte qenë i pranishëm edhe zyrtari për shërbime sociale. Ka kërkuar që rasti të trajtohet në vazhdimësi me prezencë, përfshirë edhe prezencën e Ambasadës Amerikane, si dhe ka shprehur shqetësim në aspektin profesional të vlerësimit, duke e cilësuar atë si të njëanshëm", ka deklaruar ajo.

E pyetur nëse kishte ndërmarrë ndonjë veprim pas shqetësimeve të paraqitura nga Zekaj, drejtoresha ka thënë se menjëherë kishte ftuar udhëheqësin e shërbimit social, me qëllim që ai ta udhëzonte të ndjerën për të drejtat dhe procedurat që duhej të ndiqeshin. "Menjëherë sapo e kam kuptuar arsyen e takimit, e kam ftuar udhëheqësin e shërbimit social, në cilësinë e profesionistit, për ta udhëzuar palën se çfarë të drejtash kishte dhe cilat ishin procedurat në vijim. Udhëheqësi i ka kërkuar Arlindës që të gjitha kërkesat dhe ankesat t'i dorëzonte me shkrim, në mënyrë që më pas të shqyrtohej mënyra e trajtimit të tyre", ka thënë Mujaj-Bajraktaraj.



AKB: MBI 7 MILIARDË EURO REMITANCA NGA DIASPORA, VETËM 2 PËR QIND ORIENTOHEN NË BIZNES DHE PRODHIM

PRISHTINË, 20 NËNTOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka ngritur shqetësimin për orientimin e pamjaftueshëm të kapitalit të diasporës drejt investimeve produktive, industrisë dhe prodhimit vendor.

Sipas një studimi të AKB-së, gjatë periudhës 2021 - qershor 2026 Kosova ka pranuar gjithsej 7.16 miliardë euro remitanca nga diaspora, duke shënuar kontribut të rëndësishëm për ekonominë dhe mirëqenien e qytetarëve. Megjithatë, sipas vlerësimit të AKB-së, vetëm rreth 2 për qind e këtij kapitali orientohet drejt biznesit, industrisë dhe prodhimit, ndërsa rreth 80 për qind shkon për konsum të përditshëm, patundshmëri dhe ndërtim. Pjesa tjetër, rreth 18 për qind, destinohet për fusha të tjera.

Nëse kjo strukturë orientimi zbatohet mbi shumën e përgjithshme të remitancave, rreth 5.73 miliardë euro do të ishin orientuar në konsum, patundshmëri dhe ndërtim, rreth 143 milionë euro në biznes dhe prodhim, ndërsa 1.29 miliard euro në destinime të tjera.

AKB vlerëson se, pavarësisht prej potencialit të madh financiar të diasporës, ky kapital ende nuk po shfrytëzohet sa duhet për krijimin e ndërmarrjeve prodhuese, hapjen e fabrikave, zhvillimin e industrisë dhe rritjen e eksporteve. "Kosova ndërton banesa, por nuk po ndërton mjaftueshëm fabrika për prodhim të qëndrueshëm!", thuhet në studim. Sipas AKB-së, kjo gjendje duhet të jetë shqetësim serioz për institucionet e Kosovës, pasi diaspora nuk mund të orientohet drejt investimeve prodhuese pa kushte të favorshme, siguri juridike, lehtësira fiskale dhe politika konkrete për mbështetjen e investimeve.

Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës hartimin e një strategjie të veçantë për orientimin e kapitalit të diasporës drejt industrisë, prodhimit vendor, teknologjisë dhe eksportit. "Është koha që diaspora të mos shihet vetëm si burim i remitancave për konsum, por si partnere strategjike e zhvillimit ekonomik të Kosovës. Kosovës nuk i duhen vetëm remitanca për konsum, por investime që ndërtojnë fabrika, krijojnë vende pune, rritin eksportin dhe sigurojnë të ardhmen ekonomike", ka thënë Shahini.

SI U FORMUA UÇK-ja NË JUNIK



Shkruan: Hajdin ABAZI

Ndonëse e kam thënë edhe më përpara, por në kontekst të këtij trajtimi, do t'i sjell në kujtesën publike disa të dhëna relevante se si është formuar UÇK-ja në Junik e mandej edhe në Rekë të Keqe.



Qëndrimi politik i LDK-së ishte i padrejtë ndaj anëtarësisë së gjerë të saj

Pas përfundimit të luftës çlirimtare, sidomos, LDK-ja është ndodhur në një pozitë të dyfishtë në raport me UÇK-në.
Në nivelin qendror nuk reflektuan asnjëherë qartë dhe publikisht lidhur me politikën pacifiste edhe pas Rambujesë kur shihej se ajo nuk po jepte as dhe një fryt të vetëm më dhe kur lufta çlirimtare përfshiu tërë Kosovën, e pikërisht kjo e pengoi LDK që ta artikulonte dhe ta kthente në vlerë edhe të saj kontributin që e kishte dhënë anëtarësia e saj e gjerë në terren.
Ky qëndrim ishte i padrejtë; i padrejtë ndaj vetë anëtarësisë së LDK-së.
Sepse, sa i përket gjendjes në terren dhe në fronte të luftës, nuk kishte atëherë dhe nuk ka as sot asnjë arsye të ndjehet sikur UÇK-ja nuk ishte edhe e LDK-së.
Kjo pati bërë që pjesa dërrmuese e veprimtarëve të LDK-së që kishin ndihmuar e marrë pjesë në UÇK, të largoheshin prej saj dhe u përfshinë në parti të tjera. Ky ishte çmimi fillestar që e pagoi ajo; e që herë-herë edhe sot i shfaqet si barrierë.
Sigurisht, nuk ka qenë ideale dhe as ashtu sikurse do të ishte dashur, por as nuk duhet tejdimensionuar ndonjë qëndrim a pikëpamje, ndërmarrje a përpjekje, e kujtdo qoftë që mund të kishin ngarkesa personale qoftë nga eksponentë të LDK-së e qoftë nga të UÇK-së, që e ushqente gabimisht dikotominë e radhëve ushtarake të luftës çlirimtare thuaja deri në armiqësi. Në këtë frymë, ka pasur dhe një tendencë përçarëse, që të organizohet në një rast përvjetori i parë i çlirimit jo vetëm në organizim komunal, po si rivalitet të organizohej edhe nga LDK-ja në të njëjtën kohë dhe në hapësirën afër - e që ju doli tejet të zbehtë, me çka u dha përgjigja nga populli dhe anëtarësia e gjerë e LDK-së nuk e donin konfliktin dhe përçarjen kur janë në pyetje interesat kombëtare.
E keqja nuk u përkrah, sepse nga veprimtarë të të gjitha partive politike që e donin lirinë përtej karrierës, interesit meskin dhe që e dinin se përçarja mund të çonte në luftë civile, u amortizuan dhe u shuan gradualisht veprimet e tilla.
Duhet të kihet parasysh se nuk janë pikëpamjet, mendimet, hamendësimet, dyshimet, rezervat, frika (nga mosnjohja e ndërsjellë në nivel personal, apo nga infiltrimet e spiunazhit serb), ose ndonjë ingredientë tjetër aksidental që e bën historinë, ani se mund të tregojnë botëkuptimet ekzistuese aty-këtu; jo, është realiteti ajo që është e vërtetë, që tashmë i përket historisë së lavdishme të luftës çlirimtare.
E ai realitet, po te mund të kthehet pas si një film, do të shihej se përballë armikut shqiptarët ishin unik, se që të gjithë luftonin për kombin dhe kundër pushtuesit.
Ky ishte kufiri kombëtar, që, përkundër divergjencave, mospajtimeve e ndonjë veprimi të gabuar, i bëri shqiptarët të mbeten në taborin e lirisë e të luftës çlirimtare.
Kjo është ana e ndritshme e madhështisë së luftës çlirimtare të shqiptarëve të fundshekullit XX, e cila nuk lejoi të degradonte e të degjeneronte rezistencën e armatosur në luftë vëllavrasëse; dhe këtu kanë hise të gjithë ata, nga të dyja organizimet ushtarake, që kanë kontribuar për amortizimin e ndonjë përpjekjeje të gabuar, shuarjen e saj, mos devijimin e objektivit madhor të luftës sonë çlirimtare e deri te bashkërendimi në front lufte. Kjo është historia, fryti i vërtetë i saj.

Juniku ishte organizuar mëvetësishëm në luftën çlirimtare

Lufta çlirimtare në Junik ka disa specifika, që pak janë afirmuar, e pra paraqesin një thesar të vërtetë të vlerave politike, partiake, kombëtare dhe të unitetit për liri e që tregonte nivelit e lartë të ndërgjegjes së tyre shqiptare.
Në Junik, edhe më parë kishte pasur nisma për organizim të njësive të UÇK-së, nga që Juniku kishte shërbyer si vendndalim për vullnetarët që shkonin të furnizoheshin me armë e municione në Shqipëri dhe ktheheshin pastaj për në vijat e frontit. Kjo do të mbetet kontributi po ashtu i madh edhe kur Juniku u shndërrua në nënzonë të lirë të UÇK-së. Madje, sikurse e kam theksuar edhe më parë, qoftë edhe vetëm për këtë mikpritje bujare, me pritje e përcjellje të vullnetarëve, ku strehoheshin, flinin, çlodheshin dhe ushqeheshin - Juniku dhe junikasit do të përbënin një faqe të lavdishme për këtë kontribut.
Porse, në Junik pati shumë më shumë se kaq.
Rezistenca e armatosur në Juniku kishte nisur më 29 maj 1998, kur ishin rrethuar dhe sulmuar nga forcat agresore serbe dhe junikasit kishin vendosur të mos dorëzoheshin, të mos i nënshtroheshin atij agresioni dhe hapën front lufte për të mbrojtur Junikun, familjet dhe njerëzit nga terrori serb, dhe që do të bëhej një vatër e madhe e luftës çlirimtare.
Junikasit kishin vepruar historikisht drejt, as herët e as vonë, po pikërisht kur duhej të tregohej se shqiptarët nuk e pranojnë robërinë serbe.
Në këtë gjendje të mobilizuar dhe të vetorganizuar e gjetëm junikasit kur në ditët e para të qershor të vitit 1998 mbërritëm në Junik grupi i vullnetarëve të UCK të prirë nga major Sali Veseli.
Një natë qëndruam në odën e Nimon Tofajt, i cili na priti me bujari dhe gëzim. U mblodh shtabi lokal i UÇK-së për Junik, me komandantin e tyre Gani Shehu. Aty u bisedua për gjendjen organizative, mobilizimin dhe për nevojat e ngutshme.
Nga dritarja e odës, e cila ndodhej në katin e dytë, Nimoni na i tregonte pozicionet e forcave serbe që nuk ishin më larg se 400-500 m në vijë ajrore.
Të nesërmen në mbrëmje u nisëm për në Gllogjan, ku u takuam me komandantin e Zonës Operative të UÇK-së për Rrafsh të Dukagjinit, z. Ramush Haradinaj.
Pas shkëmbimit të informatave të përgjithshme, biseda u përqendrua për gjendjen në Junik dhe Rekë të Keqe, prej nga vinte edhe major Veseli, prej fshatit Smolicë; se rezistenca kishte filluar atje porse kishin nevojë të ndihmoheshin për organizim dhe se duhej të përforcoheshin e një ushtarak si major Veseli ishte ajo që i duhej asaj treve.
Komandant Ramush Haradinaj, për shkak të specifikave të asaj treve, mori vendim që të formohej si nënzonë operative e UÇK-së.
U kthyem për të zbatuar urdhrin për formonin Shtabit të Nënzonës Operative të UÇK për Junik dhe Rekë të Keqe. Nën komandën e Sali Veselit, nisi konsolidimi ushtarak i shtabeve të fshatrave, formimi i njësiteve, i kompanive, njësiteve dhe i brigadës së UÇK për Rekë të Keqe, ku u përfshinë thuaja të gjitha fshatrat.
Me gjithë përpjekjet dhe arritjet, fryma e pjesëtarëve të UCK qe dhe mbeti e njerëzve vullnetar.

Pjesëtarë të FARK-ut erdhën tek UÇK-ja në Junik

Diku rreth dy javë pasi ishte konsoliduar dhe përfunduar organizimi e sistemimi ushtarak i shtabeve të Nënzonës Operative të Junikut e të Rekës së Keqe, ndodhi një zhvillim i këndshëm.
Diku kah fundi i qershorit 1998, erdhën disa pjesëtarë të FARK-ut në Junik, nëse nuk gaboj quhej Brigada 138, me 138 pjesëtarë ku përfshiheshin 23 oficerë dhe epror ushtarak e profesionistë, nën komandën e kolonel Tahir Zemajt.
Kur morëm vesh, të gjithë u gëzuam.
Mbi të gjitha, sepse ato që na i kishte thënë kolonel Ahmet Krasniqi, dolën të vërteta.
Kjo brigadë u stacionua në Jasiq, një paralagje e Junikut.
Komandanti i Shtabit të Nënzonës Operative të UÇK për Rekë të Keqe, majori Sali Veseli, i gëzuar për ardhjen e tyre, organizoi pritje. Por koloneli Zemaj refuzoi. Kjo shkaktoi tensione, më tepër të karakterit procedural të tipit: Ke leje për të hyrë në një zonë ushtarake komandës së të cilës nuk i subordinohesh?
Kishte diçka që nuk shkonte.
Situata u bë e nxehtë dhe potenciale për konflikt.
Kjo ishte gjendja më e rëndë gjatë tërë periudhës së luftës çlirimtare ku unë kam qenë prezent.
Oficeri Naim Maloku, që ishte në strukturën e UÇK-së për Rekën e Keqe, duke qenë se i njihte personalisht disa prej oficerëve të FARK-ut, komunikonte me ta për të gjetur një zgjidhje.

Porse, në këtë nivel lokal ishte zor të arrihej ai objektiv; sidomos kur pretendimet ishin përtej kompetencave të Shtabit të Nënzonës Operative të UÇK-së për Junik dhe Rekë të Keqe.
Kjo gjendje mund të ndryshohej vetëm nga lart.
Ndaj i kam kërkuar leje major Veselit që të shkoj e ta njoftoj komandantin e Zonës, z. Ramush Haradinaj, duke besuar se ai do të menaxhonte situatën.
Pasi mu dha leja, u nisa. Në Gllogjan i raportova për gjendjen në Junik. Ramush Haradinaj, me intuitën e komandantit, e kapi saktë rrezikun. Mori armët e tij dhe, pa humbur kohë, u nisëm për në Junik.
Në një odë në Junik, ai i mblodhi të dyja palët dhe arriti zgjidhjen: bashkëpunimin dhe integrimin.
Me urdhrin e Komandant Ramush Haradinajt, Shtabi ynë i Nënzonës organizoi përcjelljen e forcave te FARK- ut në drejtim të Gllogjanit, duke kaluar në afërsi të postblloqeve serbe, por, për fat, pa asnjë incident.
Kështu, nga vullneti i dyanshëm, u evitua një acarim që mund të eskalonte.
As një gërvishtje e vetme e as

kacafytje madje nuk pati. Mbretëroi, në fund të fundit, vetëdija kombëtare se ne kemi vetëm një armik - forcat agresore serbe.
Duhet theksuar se edhe kjo brigadë e FARK-ut në uniformat e tyre kishin emblemën e UÇK-së - dhe unë nuk kam parë asnjë pjesëtarë të tyre të kishte ndonjë emblemë tjetër.
UÇK jo se jo por as FARK asnjëherë nuk e ndryshoi kursin e vet kundër forcave ushtarake, policore e paramilitare të Serbisë as ndaj komunitetit serb në Kosovë e lëre më ndaj shqiptarëve - e pikërisht kjo ishte ajo që na përbashkonte.
Dihet se të integruar në radhët e UÇK-së, pjesëtarët e forcave nën komandën e kolonel Tahir Zemajt morën pjesë në fronte lufte kundër forcave pushtuese serbe në Loxhë dhe në fshatin Llukë.

Bashkëveprimi në aksione të përbashkëta në Junik

Një pjesë e forcave të FARK-ut, nën komandën e Rrustem Berishës dhe Agim Ramadanit, mbetën të stacionuara në Junik, në paralagjen Jasiq.
Ata do të bashkërendoheshin në të gjitha aksionet e UÇK-së në mbrojtje të Junikut dhe në aksione të tjera.
Agim Ramadani, si oficer që ishte, pranoi kërkesën e Shtabit të Nënzonës sonë Operative që t'i stërviste ushtarakisht pjesëtarët e UÇK-së. Stërvitja ushtarake ishte nevojë jashtëzakonisht e madhe, pasi që thuaja të gjithë pjesëtarët e UÇK-së ishin vullnetarë dhe nuk kishin as arsimim e madje as përvojë ushtarake. Këto stërvitje bënë të përmirësohej organizimi, megjithëse asnjëherë nuk ndryshoi karakteri vullnetar, për shkak se nuk kishim mekanizma të mirëfilltë institucional për t'i implementuar disiplinat.
Shtabi i Nënzonës sonë të UÇK-së ndërmori një kundërofensivë ndaj rrethimit që forcat serbe i kishin bërë Junikut, në ditët e para të gushtit1998, kur tanket serbe afër paralagjes së quajtur Kallavaj duke e ndarë Junikun nga pjesa tjetër e Rekës së Keqe. Në këtë luftë mori pjesë edhe oficeri Rrustem Berisha.
Asokohe major Sali Veselin e kishin angazhuar në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, kurse për drejtimin e Shtabit të Nënzonës sonë të UÇK-së ishte ngarkuar kapiten Aziz Hyseni.
Më kujtohet, kur, në një rast, Aziz Hyseni i tha Rrustem Berishës se ti je nga kjo trevë dhe ke gradë ushtarake më të lartë se unë, ndaj dhe të takon ta drejtosh luftën dhe urdhëro e merre postin e komandantit, unë po ta liroj vendin. Rrustem Berisha e falënderoi por nuk pranoi.

Si u bë UÇK-ja në Junik?

Përtej këtyre veprimeve me karakter kombëtar, që nuk ishin projektuar por që nga ndërgjegjja kombëtare u bënë si duhet dhe që i tejkaluan ndasitë dhe i kthyen ato në potencial të përbashkët të rezistencës sonë të armatosur - kishte edhe më.
Ka diçka tepër të veçantë dhe njëherësh të jashtëzakonshme që shpreh thelbin e ndërgjegjes së lartë patriotike të shqiptarëve sidomos në Junik, po thuaja edhe në shumicën e vendeve në Kosovë luftës çlirimtare në vitet 1998-1999.
Juniku është tepër i veçantë!
Në të vërtetë, UÇK-ja e Junikut.
Dhe e kam fjalën, për organizimin fillestar të vetë junikasve, kur ata formuan shtabin lokal të UÇK-së për Junik për të organizuar rezistencën e armatosur të Junikut, që e gjetëm veç të krye të detyrës kur grupi ynë i vullnetarëve me major Sali Veselin në krye shkuam në Junik Veçantia e këtij shtabi ishte përbërja e tij.
Në Junik ekzistonin dy parti politike, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Partia Republikane e Kosovës (PRK). Bashkëpunimi partiak e politik ishte karakteristikë midis këtyre partive në Junik. Dhe po kjo përvojë kombëtare, kishte ndikim edhe në formimin e shtabit lokal të UÇK-së nga junikasit.
Në krye të përgjegjësisë historike në rrethana lufte kishin vendosur me konsensus të plotë që të pushonin aktivitetin partiak dhe të organizoheshin në vetëmbrojtje.
Proporcioni ishte 7 (nga LDK) me 5 (nga PRK), që secili kishte përgjegjësi dhe funksiononin si një trup unik operativ.
Ka edhe më.
Komandant i Shtabit të UÇK-së për Junik u zgjodh Gani Shehu, kryetari i deriatëhershëm i LDK-së; zëvendës komandant u zgjodh Nimon Tofaj, nënkryetari i deriatëhershëm i LDK-së.
Gani Shehu si Komandant e Nimon Tofaj Zëvendës-Komandant u bënë figurat historike të luftës çlirimtare.
Që të gjithët i qëndruan besnikë UÇK-së dhe idealit të çlirimit të atdheut.
Madje Gani Shehu dhe Nimon Tofaj edhe do të plagoseshin.

Gani Shehu, pasi që kishte shkuar për shërim në ShBA, nga atje do të kthehet si komandant i Batalionit "Atlantiku", që do të marrë pjesë në Operacionin "Shigjeta".

Fshatrat e Rekës së Keqe ndoqën shembullin e Junikut

Duke u ndodhur në kushte e rrethana të ngjashme si Juniku, fshatrat e Rekës së Keqe i ndikuan dhe ndoqën modelin e organizimit të shtabeve lokale të UÇK-së së secilit fshat.
Në shumicën e tyre.
Mënyra e organizimit të UÇK-së në Junik pati jehonë dhe ndikim në organizimin e rezistencës së armatosur edhe në fshatrat e Rekës së Keqe.
LDK-ja dhe partitë e tjera të fshatrave formuan shtabet e tyre të UÇK-së.
Më pas, nën udhëheqjen e major Sali Veselit, këto shtabe lokale të UÇK-së do të lidhen strukturalisht dhe do të vihen nën Shtabin e Nënzonës Operative të UÇK-së për Junik dhe Rekë të Keqe.
Puna organizative ndonëse, u sendërtua formalisht si strukturë, nuk arriti të vihej mirëfilli në funksion hierarkik ushtarak edhe për shkak se nuk patëm kohë të konsolidoheshim nga që ishim thuaja çdo ditë në luftime, po edhe për shkak se karakteri vullnetar mbeti tipik.

ShBA-së iu dha mesazhi i unitetit kombëtar për luftën çlirimtare

Frymën e krejt këtij uniteti të ndërgjegjshëm kombëtar e shpreh edhe fjalia emblematike që Gani Shehu, Komandanti i Shtabit të UÇK-së për Junik, ia tha ambasadorit Richard Holbrooke.
Ky, realisht, ishte momenti kulmor i takimit të UÇK-së me emisarin special të presidentit Clinton, ambasadorin Holbrooke më 24 qershor 1998 në Junik.
Pasi që unë bëra ekspozenë për objektivat e luftës kundër forcave të armatosura serbe dhe jo kundër civilëve serb dhe për qëllimin përfundimtar të luftës sonë e që ishte çlirimi i Kosovës, Holbrooke iu drejtua Gani Shehut -, e një pyetje të papritur, që tingëllonte edhe si provokim po edhe si nxitje për ta shquar gjendjen reale në terren.
Holbrooke tha: "Ti, si kryetar i LDK-së për Junik, çfarë thua për këto?!".
Përgjigja e Gani Shehut, pa ekuivokë, konkrete dhe e shkurtë por kristalshëm e qartë ishte edhe saktësisht e vërtetë edhe po aq historike: "z. Holbrooke, në Junik, LDK dhe UÇK janë një dhe të pandashëm. Nuk ka më këtu parti politike - as LDK as Parti Parlamentare, asnjë. Ka vetëm UÇK, sepse neve po na rrezikohet jeta jonë, familjet tona; qenia shqiptare po na rrezikohet! Prandaj, këtu nuk ka ndasi. UÇK-ja në Junik është unike, një dhe e pandarë. Jemi bashkë, të gjithë jemi UÇK! Nuk ka tjetër!"
Ky pohim, i dha përgjigjen jashtëzakonisht të fuqishme ambasadorit Holbrooke. Ajo mbi të gjitha, ishte e vërtetë, jo vetëm figurativisht, por edhe realisht, për gjendjen në terren dhe raportet midis UÇK-së në Junik që kishte lindur nga LDK dhe PRK.
Kjo përgjigje e Gani Shehut, jo vetëm në sy të Holbrooke tregoi unitetin kombëtar, por shprehte të vërtetën faktike të luftës sonë çlirimtare.
Mbi të gjitha, ishte mesazh për ShBA për unitetin e luftës çlirimtare në Kosovë.
Rezistenca e armatosur në Junik dhe pohimi vulosës i Gani Shehut thënë ambasadorit Holbrooke, tregojnë atë që është e jashtëzakonshme për UÇK-në: madhështinë e luftës çlirimtare, që i ndërgjegjëson njerëzit dhe gjeneron unitet kombëtar.





sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

UEFA ndëshkon Kosovën për ndeshjen me Izraelin

PRISHTINË, 20 NËNTOR - UEFA ka shqiptuar një dënim ndaj Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) për shkeljet e evidentuara gjatë ndeshjes së Kombëtares së Kosovës kundër Izraelit. Në vendimin e saj, UEFA e ka gjobitur FFK-në me gjithsej 42 250 euro. Përveç dënimit financiar, organi qeverisës i futbollit evropian ka vendosur edhe mbylljen e pjesshme të stadiumit për ndeshjen e ardhshme që Kosova do ta zhvillojë si vendase. Kjo do të thotë se përballja e radhës në Prishtinë do të zhvillohet me kufizime në tribunat e stadiumit, në përputhje me vendimin disiplinor të UEFA-s. Ndaj Federatës së Futbollit të Kosovës ishin hapur disa procedura disiplinore pas ndeshjes me Izraelin, ndërsa vendimi i fundit sjell edhe pasoja financiare dhe organizative për federatën. FFK-ja duhet ta paguajë gjobën prej 42 250 eurosh, ndërsa në ndeshjen e ardhshme si vendase do të jetë e detyruar ta zbatojë edhe masën e mbylljes së pjesshme të stadiumit. Ndeshja u mbyll me rezultat 0-0, ndërsa Kosova luajti për gjysmë ore pa Veldin Hoxhën, i cili mori karton të kuq.



HIDHET SHORTI PËR "PLAY-OFF" DHE ÇEREKFINALET E LIGËS SË KOMBEVE

NYON, 20 NËNTOR - Është hedhur në selinë e UEFA-s në Nyon të Zvicrës shorti për ndeshjet e "play-off"-it dhe çerekfinalet e Ligës së Kombeve. Në "play-off"-in mes Ligës A dhe B do të takohen Irlanda me Kroacinë, Bosnjë-Hercegovina me Danimarkën, Hungaria me Serbinë dhe Sllovenia me Uellsin.

Ndërkohë, në çiftet e "play-off"-it mes Ligës B dhe C, Qipro do të përballet me Maqedoninë e Veriut, Estonia me Rumaninë, Ishujt Faroe me Gjeorgjinë, ndërsa Bjellorusia me Izraelin. Në çerekfinalet e Ligës së Kombeve janë rezervuar disa përballje të nivelit më të lartë, ku vëmendja kryesore do të jetë te dueli në mes të Spanjës dhe Francës, dy prej përfaqësueseve më të forta të futbollit evropian.



Një tjetër përballje interesante është ajo në mes të Norvegjisë dhe Anglisë, ku skuadra e Erling Haalandit do të sfidojë një prej pretendenteve kryesore për trofeun. Holanda dhe Portugalia do t'i matin forcat në një duel mes dy kombëtareve me traditë të madhe, ndërsa Belgjika dhe Gjermania premtojnë një tjetër përballje të fortë, me dy skuadra që synojnë të rikthehen në majat e futbollit evropian.

Ndeshjet eliminatore zhvillohen me dy takime, ku vendos rezultati i përgjithshëm. Nëse rezultati është i barabartë pas 180 minutash, do të luhen dy periudha shtesë prej 15 minutash secila. Nëse ende nuk ka fitues, ndeshja do të vendoset me goditje penalltish. Rregulli i golave në udhëtim nuk zbatohet. Për dallim nga ndeshjet eliminatore, çerekfinalet do t'i përcaktojnë skuadrat që do të kalojnë në gjysmëfinale e më pas në finale, në garën për trofeun e Ligës së Kombeve. Ndeshjet e para të fazës "play-off" do të luhen të enjten, më 25 mars, ose të shtunën, më 27 mars 2027. Ndeshjet e kthimit janë planifikuar për të dielën, më 28 mars, ose të martën, më 30 mars.

ÇIFTET E "PLAY-OFF"-IT MES LIGËS A DHE B
Irlanda - Kroacia
Bosnja dhe Hercegovina - Danimarka
Hungaria - Serbia
Sllovenia - Uellsi

ÇIFTET E "PLAY-OFF"-IT MES LIGËS B DHE C
Qipro - Maqedonia e Veriut
Estonia - Rumania
Ishujt Faroe - Gjeorgjia
Bjellorusia - Izraeli

ÇIFTET ÇEREKFINALE TË LIGËS SË KOMBEVE
Spanja - Franca
Norvegjia - Anglia
Holanda - Portugalia
Belgjika - Gjermania

SELMIN HOXHA, ARDHJA E RE TE KOSOVA



PRISHTINË, 20 NËNTOR - Mbrojtësi i krahut të djathtë, Selmin Hoxha, i cili është pjesë e skuadrës së Zurichut, ka zgjedhur ta përfaqësojë Kosovën, kombëtare për të cilën do të luajë në të ardhmen. Përkundër mundësive për ta përfaqësuar Bosnjë-Hercegovinën, Zvicrën dhe Shqipërinë, Hoxha 23-vjeçar ka vendosur tashmë për Kosovën. Ai do të grumbullohet me "Dardanët" në muajin mars të vitit të ardhshëm, kur edhe pritet ta bëjë debutimin zyrtar me fanellën e Kosovës.

Hoxha kontaktin e parë me Federatën e Futbollit të Kosovës e kishte bërë në muajin mars, por për shkak të problemeve shëndetësore nuk ishte bashkuar në grumbullim. Në sezonin aktual Hoxha ka treguar paraqitje të mira në kampionatin zviceran, ku ka shënuar një gol dhe ka bërë dy asistime.

Si futbollist, Hoxha është zhvilluar në akademinë e Zurichut, kurse pjesë e ekipit të parë është që nga viti 2022. Me gjeneratat e reja Hoxha ka përfaqësuar Zvicrën, ku ka regjistruar tri paraqitje me ekipin U20, ndërsa prindërit e tij janë nga Kosova, saktësisht nga fshati Restelicë i komunës së Dragashit.

Arijon Ibrahimoviq: S'kam asnjë kontakt me Kloppin, me FFK-në kam biseduar disa herë

BAYERN, 20 NËNTOR - Sulmuesi i Bayern Munichut, Arijon Ibrahimoviq, i huazuar te skuadra tjetër e Bundesligës gjermane, FC Augsburg, ka folur për mundësinë e përfaqësimit të Kosovës në garat ndërkombëtare.

Ibrahimoviqi, i cili mban pasaportë gjermane dhe të Kosovës, aktualisht grumbullohet me Përfaqësuesen U21 të Gjermanisë, në një intervistë për medien gjermane "Spox", ka theksuar se ende nuk është kontaktuar nga trajneri i Kombëtares A të Gjermanisë, Jürgen Klopp. Megjithatë, ai ka thënë se ka pasur kontakte me Federatën e Futbollit të Kosovës.

"Po, kam pasur kontakte me Federatën e Kosovës. Zhvillimin pozitiv të federatës dhe të futbollit të Kosovës e përcjell me shumë respekt. Megjithatë, aktualisht fokusi im është te Përfaqësuesja U21 e Gjermanisë, për të cilën luaj me shumë kënaqësi. Natyrisht, do të kisha dashur të isha pjesë e ndeshjeve të fundit të kombëtareve, ashtu si bashkëlojtarët e mi Hennes Behrens, Anton Kade dhe Mert Komur, por u detyrova të tërhiqesha për shkak të një lëndimi në muskulin e pulpës, në mënyrë që të rikuperohesha plotësisht", ka thënë Ibrahimoviqi.

Ai ka treguar se është shumë i lidhur me Kosovën. "E vizitoj familjen time në Kosovë të paktën një herë në vit, ndonjëherë edhe më shpesh. Kjo është shumë e rëndësishme për mua", ka deklaruar Ibrahimoviqi.

I pyetur për përzgjedhjen që talenti tjetër i akademisë së Bayern Munichut, Erblin Osmani, bëri për ta përfaqësuar Kosovën, me të cilën edhe debutoi si lojtari më i ri në historinë e saj, Ibrahimoviqi ka thënë se e ka uruar atë dhe se e ka meritar këtë mundësi. "E kam uruar për debutimin dhe jam shumë i lumtur për të. Ai e ka meritar këtë mundësi", është shprehur Ibrahimoviqi.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "AUTO SELIMI " Sh.p.k. Lipjan, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve, importim dhe tregtim i pjesëve te përdorura, përfshirë pjesën e strukturës te prera te automjeteve ne Lipjan

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 11.01.2027 në ora 10:00 Objekti i Komunës së Lipjanit, në njërën nga sallat e komunës, Adresa: Rr. Shqipëria, nr. 28, 14000 Lipjan, Kosovë, do të organizohet debat publik nga kompaninë "AUTO SELIMI " Sh.p.k. Lipjan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

https://us05web.zoom.us/j/8258077002?pwd=QwVGVckSQaTjsLlOlBctaqEidOUxD9.1

Meeting ID: 825 807 7002

Passcode: i2ptcn

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për "Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve, importim dhe tregtim i pjesëve te përdorura, perfshire pjesën e strukturës te prera te automjeteve

https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me operatorin "MINERAL" L.L.C. Çiktovë e Vjeter- Gllogoc, kërkesa për Leje Mjedisore, me nr. prot. 26/736/MMPH, për bazë e betonit në Çiktovë e Vjeter- Gllogoc, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 11.12.2026, në ora: 10:00, në hapësirat e Objektit të Administratës të kompanisë "MINERAL" L.L.C. Çiktovë e Vjeter- Gllogoc, do të organizohet debat publik nga operatori "MINERAL" L.L.C. Çiktovë e Vjeter- Gllogoc, kërkesa për Leje Mjedisore, me nr. prot. 26/736/MMPH, për bazë e betonit në Çiktovë e Vjeter- Gllogoc, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

Meeting ID: 978 061 9194
Passcode: LsKi3H

https://us05web.zoom.us/j/9780619194?pwd=utLa9j36e3WHTyhKaJw72N2IbG2oQ9.1

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPH-së, për komente të publikut:

https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=MATR

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,

_____

"MINERAL" L.L.C. Çiktovë e Vjeter- Gllogoc



Zvogëlim i kapitalit nga firma EUROFAMIS Sh.A

Firma "EUROFAMIS" Sh.A, me numër UNIK IDENTIFIKUES, NUI: 811306431, me seli në Shirokë, Suharekë, bën zvogëlimin e kapitalit nga vlera 910.000,00 euro në vlerën 10.000,00 euro.

RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- DENIS JUSUFI shpalle te pavleshme diplomen dhe deftesat e vitit I ,II,III te SHMLT ARKITEKT SINANI

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K "11 Marsi " Prizren.

- Trim Rezniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p "Gjon N. Kazazi" Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.


100%
Fresh &
Natural
VIDAS
Llatte
drink
2%
TAMËL
PRODHUAR ME
FINESË DHE DASHURI
2,8%
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
JOGURT
DHALLË


ROYAL CROWN
RC
cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
Columbus, Georgia, USA


MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES